

VENDIM
Nr. 209, datë 10.4.2019

**PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAT DHE
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë përbërjen, mënyrën e funksionimit, ushtrimin e kompetencave dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

II. Përbërja e Këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 10 anëtarë që emërohen prej tij.

3. Anëtarë të KKTKJ-së, janë:

- a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) drejtori i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT);
- c) përfaqësues nga drejtoritë përgjegjëse për çështjet e trashëgimisë kulturore jomateriale në ministrinë përgjegjëse për kulturën: 2;
- ç) përfaqësues i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK): 1;
- d) jurist i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore: 1;
- dh) përfaqësues i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit: 1;
- e) personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore jomateriale, të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale ose akademike në disiplinat e etnografisë, etnomuzikologjisë, organologjisë, etnokoreologjisë, folklorit apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale: 4.

4. Anëtarët e KKTKJ-së përmbushin detyrën e përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Mandati i anëtarit të KKTKJ-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri.

6. Anëtari i KKTKJ-së, i parashikuar në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

- a) të jetë nëpunës/punonjës i nivelit drejtues të një drejtorie ose sektori;
- b) të gëzojë reputacion të lartë profesional;
- c) të ketë njohuri për trashëgiminë kulturore jomateriale;
- d) të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet e trashëgimisë kulturore;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;

7. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat “dh” dhe “e”, të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nga radhët e personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, të institucioneve të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

b) të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

c) të zotërojnë tituj akademikë.

8. Mandati i anëtarit të KKTKJ-së mbaron kur:

- a) përfundon afati 2-vjeçar, nga emërimi;
- b) lirohet nga funksioni zyrtar, përveç personaliteteve nga fusha e trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) jep dorëheqjen.

9. Anëtar i KKTKJ-së lirohet nga detyra para mandatit, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore,:

- a) kur nuk merr pjesë, pa arsye, në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të KKTKJ-së;
- b) për shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
- c) kur nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKTKJ-së;
- ç) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKTKJ-së.

III. Organizimi dhe funksionimi i këshillit

1. KKTKJ-ja mbledhet jo më pak se një herë në 6 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të veçanta, mbledhja zhvillohet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët, të cilët miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Njoftimit i bashkëlidhen edhe materiale të tjera, lidhur me çështjet e rendit të ditës. Rendi i ditës miratohet nga kryetari.

3. Mbledhja e këshillit mund të kërkohet edhe nga 1/3 e anëtareve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtareve.

4. Mbledhja e KKTKJ-së është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

5. KKTKJ-ja vendos me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Vendimet e KKTKJ-së merren me votim të hapur.

7. Anëtarët e KKTKJ-së, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

8. Kryetari i KKTKJ-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

9. KKTKJ-ja asistohet në veprimtarinë e saj nga sekretaria teknike pranë QKVT-së.

IV. Kompetencat e këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 39, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka këto kompetenca:

- a) mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore jomateriale;
- b) miraton, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;
- c) harton dhe miraton strategjinë dhe programe të zhvillimit në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- ç) ndjek dhe mbikëqyr veprimtaritë që zhvillohen në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- d) propozon programe pune për edukimin nëpërmjet trashëgimisë kulturore jomateriale;
- dh) miraton planin vjetor të aktiviteteve kombëtare që zhvillon Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale;
- e) propozon projekte dhe masat që duhen ndërmarrë për ruajtjen e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, sidomos atyre që janë në rrezik;
- ë) propozon e miraton programin e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore jomateriale, që realizohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- f) propozon dhe miraton vlerat e trashëgimisë jomateriale kombëtare për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s;
- g) miraton propozimet e QKVT-së për “Kryevlerat Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”;

gj) shqyrton propozimet e subjekteve të ndryshme për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s.

2. Me qëllim ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, KKTKJ-ja mund të kërkojë sqarime për çështje të caktuara ose raportime nga QKVT-ja apo institucione të tjera të specializuara. KKTKJ-ja mund të ngarkojë këto institucione edhe me detyrimin e kryerjes së raportimeve periodike për çështjet që janë kompetencë e këtij organi. Për raste të veçanta, KKTKJ-ja fton si pjesëmarrës të jashtëm në mbledhje edhe specialistë të fushave të ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale.

3. KKTKJ-ja shqyrton kërkesën për deklarin e interesit kulturor mbi bazën e vendimit të komisionit këshillimor përkatës për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore, të ngritur sipas nenit 59, të ligjit nr. 27/2018. Institucioni i specializuar përkatës përcjell për miratim, në parim, pranë KKTKJ-së vendimin e komisionit dhe dokumentacionin shoqërues.

V. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore.

VI. Dispozitat e fundit

Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe